



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 05.03.2025
Numër i Protokollit: 1580/2025

A.nr.154/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-Kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë me Çlirim Zeka-në cilësinë e procesmbajtësit ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.154/2025 të datës 21.01.2025 të parashtruar nga ankuesi V.M, kundër organit të punësimit Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “*Kontestim Konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 05.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **shpallet jo kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.154/2025 të datës 21.01.2025, të parashtruar nga ankuesi V.M.

A r s y e t i m

Ankuesi V.M, (*tutje referuar vetëm* ankuesi), me datë 21.01.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 416/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër njoftimit për kandidatin e suksesshëm të datës 31.12.2024 për pozitën e punës Konsulent Arkitekt i Njesisë së Menaxhimit të Programit

në Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës lidhur me konkursin për vend të lirë pune për pozitën e punës Konsulent Arkitekt i Njesisë së Menaxhimit të Programit në Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës të datës 01.08.2024, kërkon të anulohet vendimi i marrë nga komisionit vlerësues, të respektohet parimi sipas renditjes së rezultatit pas të parit vjen i dyti pastaj i treti, për shkak se kandidatja fituese i ka dorëzuar dokumentet 101 ditë pas mbylljes së konkursit, intervistimi me gojë jo i drejtë, vlerësimi poentimi jo në formë të drejtë, për mos transparencë të njoftimit dhe formës së vlerësimit poentimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 18.02.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ndërsa kjo e fundit më datë 24.02.2025 ka dërguar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 416/2025 të datës 21.01.2025 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail nga zyra e personelit MMPHI për V.M. i datës 10.01.2025; E-mail nga zyra e personelit MMPHI për V.M. i datës 18.12.2024; Njoftim për kandidatin e suksesshëm i Divizionit të Burimeve Njerëzore i MMPHI i datës 04.10.2024; Njoftim për kandidatin e suksesshëm i Divizionit të Burimeve Njerëzore i MMPHI i datës 31.12.2024; Kërkesë për çasje e V.Z. i datës 13.01.2025; E-mail nga V.T. për V.M. i datës 15.01.2025; E-mail nga V.M. për V.T. i datës 15.01.2025; E-mail nga V.T. për V.M. i datës 15.01.2025; E-mail nga V.M. për V.T. i datës 15.01.2025; E-mail nga V.M. për V.T. i datës 17.01.2025; E-mail nga V.M. për V.T. i datës 17.01.2025; E-mail nga V.T. për V.M. i datës 17.01.2025; E-mail nga H.K. për V.T. i datës 17.01.2025; E-mail nga V.T. për H.K. i datës 17.01.2025; Kërkesë për shprehje të interesit 7 pozita Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës shpallë kërkesë për shprehje të interesit për 7 pozita për Njësine e Menaxhimit të Projektit NJMP për projektin Programi i banimit adekuat social në Kosovë; Konkurs për vende të lira pune Konsulent Arkitekt i Njesisë së Menaxhimit të Programit në Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës i datës 01.08.2024; CV-ja e N.L.; Dokumentet e dorëzuara nga kandidatja N.L. nga faqe 1-28 faqe i datës 25.11.2024; Aplikacioni i V.M. i datës 15.08.2024 me dokumentacionet nga faqe 1-47 faqe; Kërkesë për përgjigje në ankesë i datës 18.02.2025; Përgjigje në ankesë i datës 24.02.2025; E-mail nga H.K. për B.K. i datës 18.02.2025; Aplikacioni i V.M. i datës 15.08.2024 me dokumentacionet nga faqe 1-25 faqe; Konkurs për vend të lirë pune për pozitën e punës Konsulent Arkitekt i Njesisë së Menaxhimit të Programit në Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës i datës

01.08.2024; Kërkesë për shprehje të interesit 5 pozita Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës shpallë kërkesë për shprehje të interesit për 5 pozita për Njësinë e Menaxhimit të Projektit NJMP për projektin Programi i banimit adekuat social në Kosovë; Konkurs për vende të lira pune Konsulent Arkitekt i Njësisë së Menaxhimit të Programit në Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës i datës 15.11.2024; Raporti mbi vlerësimin e aplikacioneve për pozitën Arkitektit të Njësisë së Menaxhimit të Programit NJMP për banim adekuat social i datës 17.01.2025; Vendim për caktim të komisionit për vlerësimin e aplikacioneve për rekrutim i U.d. Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI i datës 26.11.2024; Kontratë pune për kohë të caktuar e B.Sh. i datës 21.11.2024; E-mail nga zyra e personelit MMPHI për V.M. i datës 10.01.2025; E-mail nga zyra e personelit MMPHI për N.L. i datës 31.12.2024; E-mail nga zyra e personelit MMPHI për V.M. i datës 18.12.2024; E-mail nga zyra e personelit MMPHI për N.L. i datës 18.12.2024;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, **nuk është kompetent** për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit, fillimisht ka konstatuar se Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me datë 01.08.2024 ka shpallur konkursin për pozitën Konsulent Arkitekt i Njësisë së Menaxhimit të Programit duke u bazuar në nenin 17 paragrafi 5 nenin 47 dhe nenin 48 të Ligjit Nr.08/L-099 për Borxhin Shtetëror dhe Garancitë shtetërore, pikës 5 të Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës Përfaqësuar nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës (BZHKE) për Projektin Banimi Social Adekuat e ratifikuar me Ligjin Nr.08/L-302 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës Përfaqësuar nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës (BZHKE) për Projektin Banimi Social Adekuat dhe dispozitave ligjore të Rregullores MF-Nr.05/2017 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores MF-Nr.01/2016 për Administrimin e Fondeve të Huamarrjes e Plotësuar dhe Ndryshuar me Rregulloren MF-Nr.03/2017.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se meqenëse konkursi i datës 01.08.2024 i shpallur nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për pozitën Konsulent Arkitekt i Njësisë së Menaxhimit të Programit nuk është shpallur bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik përkatësisht nenit 39 dhe 37, Kolegji i Këshillit konstatoi se në rastin konkret pozita Konsulent Arkitekt i Njësisë së Menaxhimit të Programit nuk është pozitë e shërbimit civil.

2025/0154

Kolegji i Këshillit i'u referua fillimisht dispozitave të Ligjit N.08/L-197 për Zyrtarët Publik përkatësisht me nenin 5 paragrafin 5 ku është përcaktuar se; *1. Kategoritë e zyrtares/it publik janë: 1.1. Nëpunësja/i i shërbimit civil; 1.2. Nëpunësja/i i shërbimit publik; 1.3. Krijuesja/i dhe performuesja/i e/i artist dhe kulturës; 1.4. Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës; dhe 1.5. Zyrtarja/i i kabinetit...2. Nëpunësja/i i shërbimit civil është zyrtarja/i publik në kuadër të shërbimit civil i cili merr pjesë në formulimin dhe/apo zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave dhe procedurave administrative dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme profesionale dhe administrative në zbatim. Nëpunësja/i i shërbimit civil ushtron detyrën në pozitën përkatëse, duke filluar nga zyrtarja/i profesional deri në pozitën e drejtueses/it të lartë, në administratën e Presidentes/it të Republikës së Kosovës, në administratën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në Zyrën e Kryeministres/it të Republikës së Kosovës, në Ministri, në Agjenci Ekzekutive dhe në degë lokale të tyre, institucione të pavarura kushtetuese, në agjenci të pavarura dhe rregullatore, në administratën komunale dhe çdo nëpunës/ës statusi i të cilit është përcaktuar si nëpunës/ës i shërbimit civil, me ligj të veçantë.* 3. Nëpunësja/i i shërbimit publik është zyrtarja/i publik i cili ofron shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit, në fushën e mjekësisë ligjore, si dhe shërbime tjera të ngjashme publike. Nëpunësja/i i shërbimit publik ushtron detyrën në pozitën përkatëse duke filluar nga niveli profesional deri në nivelin e lartë drejtues. Nëpunësja/i i shërbimit publik është edhe nëpunësja/i i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike pjesë e administratës shtetërore, në administratën e shërbimeve publike apo pjesë e komunës. 4. Krijuesja/i dhe performuesja/i i artit dhe kulturës është zyrtarja/i publik që ushtron profesionin e saj/tij artistik në një institucion të artit apo të kulturës. 5. Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës është zyrtarja/i publik që kryen veprimtari ndihmëse të mirëmbajtjes, të ruajtjes, të vozitjes dhe veprimtari të ngjashme në institucionet publike. 6. Zyrtarja/i i Kabinetit është zyrtarja/i publik, që ushtron detyrën në Kabinetin e Presidentes/it të Republikës së Kosovës, të Kryetares/it të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të Kryetares/it të Gjykatës Kushtetuese, të Kryeministres/it të Republikës së Kosovës, të Zëvendëskryeministres/it, të Ministres/it ose të titullares/it të institucionit të pavarur kushtetues, si dhe të Kryetares/it dhe nënkryetares/it të Komunës. Zyrtarja/i i kabinetit ushtron detyrën e udhëheqëses/it të kabinetit, këshilltares/it, ndihmëses/it apo zëdhënëses/it të titullares/it të kabinetit, si dhe stafit teknik dhe mbështetës të kabinetit. Statusin e zyrtares/it të kabinetit e kanë edhe nëpunëset/it të cilët ushtrojnë detyrat për nën kryetaren/in e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe për grupin parlamentar.

Në kuptim të nenit 101 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi, sepse Këshilli është kompetent që të

shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil.

Andaj pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.154/2025

Çlirim Zeka

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit V.M.
- Udhëheqësit të Personelit të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.